

PROCESVERBAL 27/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 2 (dytë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitetet, mbajtur me datë 27.02.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;

4.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që është kërkesë nga Drejtoria e Pronës që të fillohet procedura për dhënie në shfrytëzim të dy lokaleve afariste që gjenden në rrugën “Brigada 123”.Ne paraprakisht do ta marrim vendimin në Kuvend dhe do të fillojmë me procedurat për dhënie në shfrytëzim pasi Komuna ka interes.

Kryesuesi - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që me vendim të Kryetarit ka qenë i formuar grupi punues për hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë mirëpo për shkak të një ndryshimi që është bërë në rregulloren për çështje të transparencës ne kemi qenë të obliguar që këtë proces ta shtyejmë për pak për arsye se kemi pritur që kjo rregullore të miratohet nga Qeveria e RKS dhe në kuadër të kësaj rregullore parashihen të gjitha aktivitetet që duhet të përfshihen në kuadër të planit të veprimit për transparencë.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Të ndryshme;

Kryesuesi - hap debatin.Pasi nuk ka debat,unë dua ta ngris një shqetësim i cili është diskutu edhe më herët dhe bëhet fjalë për problemin në shkollën “Drita” në Gelancë me nxënësat e komunitetit ashkali.Ne e kemi kriju një grup prej këtij komisioni ku dhe e kemi vizitu atë shkollë.Problemi po vazhdon prap,fëmijët nuk po e vijnë procesin mësimor.Unë si kryesues i këtij komitetit desha të ju informoj për hapat që duhet ti ndërmarrim.Më është kërku edhe nga drejtorja e shkollës që të bisedoj me familjet veq e veq.Unë javën e ardhshme do të dal në shkollë dhe do ti marrë të dhënat e nxënësve dhe familjarëve të tyre dhe të dal në teren dhe të bisedoj me familjet për këtë problem.

Avni Bytyqi - vitin e kaluar ju u dakorduat që një grup punues prej komitetit me dalë në teren dhe me konstatu gjendjen dhe me ju dhënë pak autoritet mësimdhënësve.Paraprakisht është mirë që grupi punues të dal në teren,të bisedoj me familjarët e pastaj me mësimdhënësit që në një formë me i obligu nxënësat me shku në shkollë.Unë mendoj që nuk është ndonjë shkelje apo diskriminimi nëse ti i thua fëmijut dhe prindërve që e kanë obligim fëmijët me i dërgu në shkollë sidomos prej kl I-rë deri në kl IX-të sepse në të kundërtën mund të gjobiten prindërit e tyre në aspektin ligjor.

Kryesuesi - do e caktojme një ditë dhe fillimisht do të shkojmë në shkollë që ti marrim zonat e familjarëve pastaj dalim në teren dhe i njoftojme me masat ndëshkuese.

Aziz Bytyqi - ideja është shumë e mirë.Sa i takon vijueshmërisë së përfaqësuesve të atij komuniteti në procesin mësimor,atëherë jemi dakordu me një formë tjetër por nu ka asgjë.Shkojmë e konstatojmë gjendjen faktike në shkollë por shkojmë edhe te familjet e tyre dhe i flasim për rëndësinë e çështjes së shkollimit dhe për aspektin ligjor që është i fundit.E di që të gjithë pajtoheni që një fëmijë i paarsimuar është një fëmijë gjysmak dhe me një të ardhme të errët dhe e jona është që të përdorim aso metoda siq tha edhe zyrtari ligjor sepse qëllimi është pozitiv.Nëse kanë nevoj ata me kërku lëmshë,ne gjejmë forma për me ndihmu për shkollim.

Kryesuesi - ne jemi në dakordim dhe ju noftoj për veprimet të cilat duhet ti marrim më tutje dhe muajin e ardhshëm raportojme në këtë komitet.

Takimi përfundoi: 09:15